



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 628/3 Prot.

Durrës më, 17/02 / 2025

VENDIM

Nr 12, datë 17.02 2025

"Për një shtesë në vendimin e Bordit të Administrimit nr. 37, datë 10.07.2024 "Për miratimin e shpërblimit të komisioneve KIZ, KZF, KA për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës 2024"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë, të urdhërit MAS nr.101, datë 13.03.2024 "Për zhvillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", neni 6 pika 7, neni 7 pika 12, neni 39 pika 7 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës" miratuar me vendim Senati Akademik nr.29, datë 29.03.2024, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr. 37, datë 10.07.2024 "Për miratimin e shpërblimit të komisioneve KIZ, KZF, KA për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës 2024", të shtohet:
-Mënyra e shpërblimit komisioneve KIZ, KZF, KA, do të jetë një herë në 4 vite, për procesin e zgjedhor kryesor për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet :
 - Administratori
 - Drejtoria e Administrimit Financiar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

